



BASHKIA VLORË – DREJTORIA E URBANISTIKËS

# RIKONSTRUKSION I RRUGËS “DONIKA KASTRIOTI”.

**RELACION PËRSHKRIMI**

## RELACION PËRSHKRIMI

### 1. Rruga “Donika Kastrioti”.

Rruga “Donika Kastrioti” fillon në kryqëzimin e rrugës kryesore për Kaninë dhe rrugës Sulejman Delvina. Rruga është e gjatë rreth 330m dhe është rrugë lidhëse kryesore për banorët e zonës me pjesën tjetër të qytetit. E rrethuar kryesisht me shtëpi private deri në tre kate dhe gjelbërim.



Për realizimin e këtij projekti janë kryer studime në terren të gjendjes faktike të rrugës në të gjithë gjatësinë e saj. Mungesa e investimeve në kete segment ka çuar në një gjendje ku nevojiten ndërhyrje të menjëhershme. Këto ndërhyrje duhet të jenë në të gjithë sipërfaqen e segmentit rrugor.

Ndërhyrja e përgjithshme do të konsistojë në të gjithë gjatësinë e rrugës si dhe rindërtimi i pjesëshëm i një kunete kulluese anësore.

Shtresat që do të përdoren në të gjithë rrjetin rrugor janë si me poshtë

- shtresë stabilizanti 10 cm
- shtresë binderi 4 cm
- shtresë asfalto betoni 4 cm.

## *Gjendja ekzistuese e trupit te rrugës*



Projekti parashikon riasfaltimin e plotë të rrugës dhe riparimi i dëmeve të lokalizuara.

Rruga ekzistuese përpara fillimit të punimeve do të rafshohet me eskavator dhe mbasi të realizohet një profil i një trajtshëm do të shtrohet mbi rrugë një tapet stabilizanti 10 cm në të gjithë gjatësinë e rrugës. Përpara fillimit të shtresave asfaltike do të realizohet kunetë kulluese anësore i hapur në pjesën ku mungon. Mbi tapetin e stabilizantit do të plotësohet më tej shtresa e binderit 4cm dhe e asfaltobetonit 4 cm. Mbas perfundimit të shtresave puna do të vijojë me tej me vijëzimin gjatësor të rrugës. Rruga ka gjatësinë rreth 330 ml.

PUNOI: Ark. Erisa Muka  
Ark.Orges Deraj  
Urb.Evangjelica Rapaj  
Ing.Darjan Hudhra

